

PASQYRAT FINANCIARE DHE DOKUMENTET SHOQERUESE

31 DHJETOR 2016

Agrotal 2 sh.p.k.

NIPT:	K922020300		
Data e krijimit:	2 tetor 2009		
Adresa:	Rruga Pjeter Bogdani, Godina 2-6,kati 2, Tirane		
Fusha e veprimtarisë:	Administrim i masivit te ullirit		
Standardet e aplikuara të kontabilitetit:	SKK	<input checked="" type="checkbox"/>	SNRF <input type="checkbox"/>
Lloji i pasqyrave:	Individuale	<input checked="" type="checkbox"/>	Të konsoliduara <input type="checkbox"/>
Monedha/Rrumbullakimi:	Lek (të plotë, pa qindarka)		
Data e plotësimit:	31 mars 2017		

Agrotal 2 sh.p.k.

**Pasqyrat Financiare
31 dhjetor 2016**

Permbajtja:

	Faqe
Pasqyra e pozicionit financiar me 31 dhjetor 2016	2
Pasqyra e te ardhurave gjithepfshirese per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2016	3
Pasqyra e ndryshimeve ne kapital per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2016	4
Pasqyra e flukseve monetare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2016	5
Shenime shpjeguese te pasqyrave financiare	6 - 13

Agrotal 2 sh.p.k.
Pasqyra e pozicionit financiar
me 31 dhjetor 2016

(shumat ne Lek)

	Shenime shpjeguese	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
<u>Aktivët</u>			
I Aktivët afatshkurtra			
Mjete monetare	4	8,212	53,072
Aktive financiare afatshkurtra	5	1,227,729	1,143,240
Inventari	6	-	-
Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra	7	-	-
Total i aktiveve afatshkurtra (I)		1,235,941	1,196,312
II Aktivët afatgjata			
Aktive afatgjata materiale	8	135,322	177,607
Aktive afatgjata jomateriale	8	-	-
Aktive biologjike	9	9,810,000	-
Shpenzimet e zhvillimit		26,847,665	22,509,257
Totali i aktiveve afatgjata (II)		36,792,987	22,686,864
Totali i aktiveve (I,II)		38,028,928	23,883,176
<u>Detyrimet dhe kapitali</u>			
I Detyrimet afatshkurtra			
Detyrimet per t'u paguar dhe parapagimet	10	28,308,571	23,963,166
Totali i detyrimeve afatshkurtra (I)		28,308,571	23,963,166
II. Detyrimet afatgjata			
Totali i detyrimeve afatgjata (II)		-	-
Totali i detyrimeve (I,II)		28,308,571	23,963,166
III. Kapitali			
Kapitali themeltar	1	9,812,500	2,500
Fitimet (humbjet) e akumuluar		(82,490)	(82,490)
Fitimi (humbja) e vitit		(9,653)	-
Totali i kapitalit (III)		9,720,357	(79,990)
Totali i detyrimeve dhe kapitalit (I,II,III)		38,028,928	23,883,176

Pasqyra e pozicionit financiar duhet te lexohet se bashku me shenimet shpjeguese ne faqet 6 – 13 qe jane pjese perberese e pasqyrave financiare



Agrotal 2 sh.p.k.
Pasqyra e te ardhurave gjithepershires
per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2016

(shumat ne Lek)

	Shenime shpjeguese	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2016	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2015
I. Te ardhurat nga shitja			
Te ardhura nga aktiviteti	11	-	-
Te ardhura te tjera	12	-	-
Totali i shpenzimeve (I)		-	-
II. Shpenzimet			
Shpenzime administrative	13	(9,653)	-
Kosto e punes:			
Pagat dhe shperblimet e personelit	14	-	-
Sigurimet shoqerore dhe shendetesore	14	-	-
Amortizimi	8	-	-
Totali i shpenzimeve (II)		(9,653)	-
Fitimi (humbja) nga veprimtaria kryesore (I-II)		(9,653)	-
III. Te ardhurat dhe shpenzimet financiare			
Te ardhura (shpenzime) nga kurset e kembimit, neto	15	-	-
Totali i te ardhurave dhe shpenzimeve financiare, neto (III)		-	-
Fitimi para tatimit (I-II/+III)		(9,653)	-
Tatim-fitimi	17	-	-
Fitimi neto i vitit		(9,653)	-
Te ardhura te tjera gjithepershires:			
Fitim/(humbje) ne rivleresimin e prones	-	-	-
Te ardhura gjithepershires per vitin		(9,653)	-
Fitim/(humbje) i atribueshem per:			
Pronaret e shoqerise meme		-	-
Fitimi/(humbja) per vitin		(9,653)	-
Te ardhura/(humbje) totale te atribueshme per:			
Pronaret e shoqerise meme		(9,653)	-
Interesa jo-kontrolluese		-	-
Totali i te ardhurave gjithepershires per vitin		(9,653)	-

Pasqyra e te ardhurave gjithepershires duhet te lexohet se bashku me shenimet shpjeguese ne faqet 6 – 13 qe jane pjese perberese e pasqyrave financiare.



Agrotal 2 sh.p.k.
Pasqyra e ndryshimeve ne kapital
per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2016

(shumat ne Lek)

	Kapitali i nenshkruar	Kapitali i papaguar	Fitim (humbja) e vitit	Fitim (humbja) e akumuluar	TOTALI
Pozicioni me 31 dhjetor 2014					
Fitim (humbja) e akumuluar	2,500	-	(82,490)	-	(79,990)
Shperndarje dividendi	-	-	82,490	(82,490)	-
Fitim (humbja) e vitit	-	-	-	-	-
Pozicioni me 31 dhjetor 2015	2,500	-	-	-	(79,990)
Kapitali i nenshkruar	9,810,000	-	-	(82,490)	9,810,000
Fitim (humbja) e akumuluar	-	-	-	-	-
Shperndarje dividendi	-	-	-	-	-
Fitim (humbja) e vitit	-	-	(9,653)	-	(9,653)
Pozicioni me 31 dhjetor 2016	9,812,500	-	(9,653)	(82,490)	9,720,357

Pasqyra e ndryshimeve ne kapital duhet te lexohet se bashku me shenimet shpjeguese ne faqet 6 – 13 qe jane pjese perberese e pasqyrave financiare

Agrotal 2 sh.p.k
Pasqyra e flukseve monetare
per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2016

(shumat ne Lek)

	Shenime	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2016	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2015
I. Fluksi monetar nga veprimtarite e shfrytezimit			
Fitimi (humbja) para tatimit		(9,653)	-
Rregullime per:			
Amortizim	8	42,285	55,675
Te ardhura nga interesat	16	-	-
(Rritje) zvogelim ne tepricen e kerkesave te arketueshme	5	(84,490)	-
(Rritje) zvogelim ne tepricen e parapagimeve dhe shpenzimeve te shtyra	7	-	-
Rritje (zvogelim) ne tepricen e detyrimeve per t'u paguar	9	4,345,405	988,965
Fluksi monetar nga veprimtarite e shfrytezimit		4,293,547	1,044,640
Tatim-fitimi i paguar	17	-	-
Fluksi neto monetar nga veprimtarite e shfrytezimit		4,293,547	1,044,640
II. Fluksi monetar nga veprimtarite e investimit			
Rritje te shpenzimeve te zhvillimit	8	(4,338,408)	(2,087,615)
Fluksi neto monetar nga veprimtarite e investimit		(4,338,408)	(2,087,615)
III. Fluksi monetar nga veprimtarite e financimit			
Te ardhura nga emetimi i kapitalit aksionar		-	-
Financime ortaku		-	1,088,925
Pagesat per qirane financiare	10	-	-
Fluksi neto monetar nga veprimtarite e financimit		-	1,088,925
IV. Rritja (zvogelimi) neto i mjeteve monetare		(44,861)	45,950
V. Mjetet monetare ne fillim te periudhes	4	53,072	7,122
VI. Mjetet monetare ne fund te periudhes	4	8,212	53,072

Pasqyra e flukseve monetare duhet te lexohet se bashku me shenimet shpjeguese ne faqet 6 – 13 qe jane pjese perberese e pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare te Shoqerise per periudhen e mbyllur me 31 dhjetor 2016 u aprovuan dhe u nenshkruan nga administratori si me poshte:

Administratori
Durim Meta







Agrotal 2 sh.p.k.

Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2016

(shumat ne Lek)

1. Informacion i pergjithshem

Agrotal 2 sh.p.k. (referuar si "Shoqeria") eshte regjistruar prane Qendres Kombetare te Regjistrimit si shoqeri tregtare me pergjegjesi te kufizuar me date 2 tetor 2009 dhe me Degen e Tatimeve dhe Taksave Tirane me NIPT K922020300.

Ne perputhje me statutin dhe aktin e themelimit, Shoqeria ka si objekt te vetem te veprimtarise se saj projektimin, ndertimin, venien ne shfrytezim dhe administrimin e mirembajtjen e masivit te ullirit dhe tregtimin e ullirit sipas kontrates se koncesionit nenshkruar midis shoqerise me me, Agrotal 1 sh.a. dhe Ministrise se Bujqesise, Ushqimit dhe Mbrojtjes se Konsumatorit, ratifikuar me Ligjin nr. 10082, date 23.02.2009. Sipas kontrates se koncesionit, masivi i ullirit shtrihet ne zonen e Kavajes ne komunat Synej, Luz i vogel, Kryevidh dhe Gose.

Shoqeria zoterohet nga nje ortak dhe perkatesisht Agrotal 1 sh.a. qe zoteron 100% te aksioneve. Me date 29.01.2016, Asambleja e Ortakut te Vetem miratoi vendimin per zmadhimin e kapitalit te Shoqerise ne shumen 9,810,000 Lek me kontribut ne natyre, me qellim realizimin e objektivit te aktivitetit te Shoqerise per ngritjen dhe mirembajtjen e masivit te ullirit. Me 31 dhjetor 2016 vlera e kapitalit themeltar eshte 9,812,500 Lek. Administrator i Shoqerise eshte Z. Durim Meta.

Adresa e Shoqerise eshte ne Rr. Pjeter Bogdani i Ri, Godina 2-6 kate, Tirane, Shqiperi. Me date 31 dhjetor 2016 Shoqeria ka 11 te punesuar (2015: 9).

2. Bazat e pergatitjes se pasqyrave

2.1 Pajtueshmeria

Pasqyrat financiare jane pergatitur bazuar ne Standardet Kombetare te Kontabilitetit (SKK) te shpallura me date 15 qershor 2006 ne perputhje me Ligjin 9228, date 29 prill 2004 te ndryshuar me ligjin 9477, date 9 shkurt 2006, dhe te permiresuara ne perputhje me Urdherin e Ministrit te Financave nr.64, date 22.07.2014, ne fuqi nga data 1 janar 2015.

2.2 Bazat e matjes

Pasqyrat financiare jane pergatitur bazuar ne koston historike, pervec rasteve nese specifikohet ndryshe, nese ka te tilla.

2.3 Periudhat krahasimore

Te dhenat e periudhave te meparshme jane riklasifikuar per t'i bere ato te krahasueshme me paraqitjen e te dhenave te periudhes ushtrimore.

2.4 Monedha funksionale dhe e paraqitjes


Keto pasqyra financiare jane prezantuar ne Lek, e cila eshte dhe monedha funksionale e Shoqerise.

2.5 Vleresime dhe gjykime

Pergatitja e pasqyrave financiare kerkon nga drejtuesit te ushtrojne gjykimin e tyre ne procesin e zbatimit te politikave kontabel te shoqerise dhe shumave te raportuara te aktiveve, detyrimeve, te ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund te ndryshoje ne varesi te ketyre vleresimeve.

Vleresimet dhe gjykimet rishikohen ne menyre te vazhdueshme. Rishikimet e vleresimeve kontabel jane te njohura ne periudhen ne te cilen vleresimi eshte rishikuar si dhe ne periudhat e ardhshme qe preken.

Ne vecanti, informacionet mbi fushat me te rendesishme te vleresimeve dhe gjykimeve ne aplikimin e politikave kontabel te cilat kane efektet me te rendesishme ne shumat e njohura ne pasqyrat financiare, jane pershkruar ne shenimet perkatese te pasqyrave financiare.



Agrotal 2 sh.p.k.

Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2016

(shumat ne Lek)

3. Politikat kontabel

Politikat kontabel te meposhtme jane aplikuar ne menyre konsistente nga Shoqeria, pervec rasteve kur specifikohet ndryshe.

3.1 Transaksionet ne monedhe te huaj

Transaksionet ne monedhe te huaj konvertohen ne monedhen funksionale dhe regjistrohen me kursin e kembimit ne daten e transaksionit. Asetet dhe detyrimet monetare ne monedhe te huaj ne daten e raportimit konvertohen ne monedhen funksionale me kursin e kembimit ne daten e raportimit. Fitimi ose humbja nga kembimi ne zera monetare eshte diferenca qe vjen nga kembimi i nje numri te caktuar njesish te nje monedhe te huaj ne monedhen funksionale me kurse te ndryshme kembimi ne datat e kembimit. Te drejtat dhe detyrimet jomonetare ne monedhe te huaj konvertohen ne monedhen funksionale me kursin e kembimit te dates se kryerjes se transaksionit, ndersa ato qe maten me vlere te drejte rikembepen ne monedhen funksionale me kursin e kembimit te dates kur eshte percaktuar vlere e drejte.

Diferencat qe rezultojne nga kursi i kembimit kalojne ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve.

Kurset e kembimit te perdorura ne konvertimin e asetëve dhe detyrimeve monetare ne monedhe te huaj jane:

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Euro/Lek	137.28	137.28
USD/Lek	125.79	125.79

3.2 Instrumenta financiare

Instrumentat financiare joderivative perbehen nga kerkesa per t'u arketuar, mjete monetare, hua te marra dhe te dhena, dhe detyrime per t'u paguar.

Instrumentat financiare joderivative njihen fillimisht me vleren e drejte plus çdo kosto transaksioni qe lidhet me to, pervec siç pershkruhet me poshte. Per instrumentat e mbajtur me vlere te drejte nepermjet fitim/humbje, kostot e transaksionit kalojne ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve. Ne vijim te njohjes fillestare instrumentat financiare joderivative maten siç pershkruhet me poshte.

Nje instrument financiar njihet nese shoqeria behet pale ne kushtet kontraktuale te instrumentit. Aktivitetet financiare çregjistrohen kur skadojne te drejtat kontraktuale te shoqerise mbi flukset e parase se aktivitetit financiar ose kur shoqeria transferon aktivitetin financiar tek nje pale e trete pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe perfitimet thelbesore te aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale te aktiveve financiare kontabilizohen ne daten e transaksionit, qe eshte data ne te cilen shoqeria angazhohet te bleje apo te shese aktivitetin. Detyrimet financiare çregjistrohen nese detyrimet kontraktuale te shoqerise skadojne, shfuqizohen ose anulohen.

Paraja dhe ekuivalentet e parase

Paraja dhe ekuivalentet e parase perfshijne arken, llogarite rrjedhese dhe depozitat ne te pare me bankat. Per qellimin e pasqyres se flukseve monetare, paraja dhe ekuivalentet te saj perfshijne depozita pa afat me nje maturim prej tre muajsh ose me pak qe nga data e fillimit.

Kerkesat per t'u arketuar

Kerkesat per t'u arketuar njihen fillimisht me vleren e drejte dhe me pas me kosto te amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvleresimi. Provigjoni per zhvleresimin e kerkesave per t'u arketuar llogaritet kur ka te dhena se shoqeria nuk do te jete ne gjendje te mblodhe te gjitha detyrimet. Veshtiresite financiare te debitorit, mundesia qe debitori te falimentoje ose riorganizimi i tij financiar dhe mospagesa apo pagesa e vonuar konsiderohen tregues qe llogarite e arketueshme te zhvleresohen. Shuma e

Agrotal 2 sh.p.k.

Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2016

(shumat ne Lek)

provigjoni llogaritet si diference midis vleres se mbetur dhe vleres aktuale te flukseve te ardhshme te parashikuara te parase te skontuara me normen efektive te interesit.

Detyrimet per t'u paguar

Detyrimet per t'u paguar paraqiten me vleren e tyre te drejte dhe me pas me kosto te amortizuar, duke perdorur metoden e interesit efektiv.

Hua te marra dhe te dhena

Huate e marra dhe te dhena njihen fillimisht me vleren e tregut, pa perfshire koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huate e marra dhe te dhena paraqiten me kosto te amortizuar duke njohur ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve çdo diference midis koston dhe vleres se pagueshme nominale pergjate periudhes se huamarrjes duke u bazuar ne interesin efektiv.

Vlera e drejte

Vlerat e drejta te perlllogaritura te mjeteve monetare dhe ekuivalenteve te tyre, te kerkesave per t'u arketuara, detyrimeve per t'u paguar dhe huave perafrohen me vlerat e tyre kontabel.

Te tjera

Instrumenta te tjere joderivative maten me kosto te amortizuar sipas metodes se interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvleresimi.

3.3 Aktive afatgjata materiale

(i) Njohja dhe matja

Te gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvleresimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja perfshin shpenzime te cilat lidhen drejtperdrejt me blerjen e aktivitetit. Kostoja e aktiveve te vete-ndertuara perfshin koston e materialeve dhe punes direkte, çdo kosto tjeter te lidhur drejtperdrejt me sjelljen e aktivitetit ne gjendje pune per qellimin e synuar te perdorimit, si dhe koston e çmontimit, heqjes se pjeseve dhe sjelljes ne gjendjen e meparshme te vendndodhjes se aktivitetit. Shpenzimet kapitale te bera gjate ndertimit kapitalizohen ne "Ndertim ne proces" dhe transferohen ne kategorine perkatese te aktivitetit kur perfundon ndertimi tij, nga kur aplikohet amortizimi perkates sipas kategorise.

Ne rastet kur pjese te nje aktiviteti afatgjate material kane jetegjatesi te ndryshme, ato kontabilizohen si zera te ndryshem (komponentet me te medhenj) te aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet apo nxjerrjet jashte perdorimit percaktohen duke krahasuar vleren e shitjes me vleren e mbetur, dhe keto perfshihen ne pasqyren e te ardhurave.

(ii) Kostot e mepasshme

Kostoja e zevendesimit te nje pjese te nje zeri te aktiveve afatgjata materiale njihet ne vleren kontabel te atij zeri nese eshte e mundshme qe shoqeria do te realizoje perfitime te ardhshme ekonomike nga perdorimi i pjeses zevendesuese dhe kostoja e pjeses mund te matet ne menyre te besueshme. Kostot e sherbimeve te zakonshme te aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

(iii) Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet mbi jeten e vleresuar te çdo pjese te aktiviteti afatgjate material duke filluar nga data kur aktiviteti eshte i gatshem per perdorim. Aktiviteti e marra me qira amortizohen duke perdorur metoden lineare te amortizimit mbi jeten e vleresuar te çdo pjese te aktiviteti afatgjate material dhe duke marre per baze periudhen me e shkurter midis periudhes se qirase dhe jetes se dobishme te aktivitetit. Toka nuk amortizohet.

Agrotal 2 sh.p.k.

Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2016

(shumat ne Lek)

Metodat dhe perqindjet e amortizimit per secilen kategori aktivesh afatgjata per periudhen aktuale jane si me poshte:

Permiresim ne qiramarrje	Mbi vleren kontabel neto	5%
Mobilje dhe orendi	Mbi vleren kontabel neto	20%
Pajisje dhe programe IT	Mbi vleren kontabel neto	25%
Te tjera aktive	Mbi vleren kontabel neto	20%

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen ne çdo date raportimi.

3.4 Aktivet biologjike

Aktivitet biologjike jane kafshe te gjalla ose bime te cilat i nenshtrohen transformimit biologjik te rritjes, shnderrimit, prodhimit dhe mbareshtimit. Aktivitet biologjike njihen fillimisht me koston e blerjes ose te prodhimit. Aktivitet biologjike te cilat priten te realizohen brenda 12 muajve nga data e bilancit, klasifikohen si aktive biologjike afatshkurtra. Pas njohjes fillestare, aktivitet biologjike mbahen me kosto te amortizuar duke zbritur zhvleresimin. Aktivitet biologjike afatshkurtra mbahen pas njohjes fillestare me kosto duke zbritur zhvleresimin. Prodhimi bujqesor njihet si inventar.

3.5 Zhvleresimi

(i) Aktivet financiare

Nje aktiv financiar konsiderohet i zhvleresuar nese ka te dhena objektive qe tregojne se nje apo disa ngjarje kane efekte negative ne flukset e ardhshme qe parashikohet te burojne nga aktivi.

Nje zhvleresim ne lidhje me aktivin financiar, te matur me kosto te amortizuar, llogaritet si diference midis vleres se mbetur dhe vleres aktuale te flukseve te ardhshme te parashikuara te parase te skontuara me normen efektive te interesit.

Aktivitet financiare te rendesishme individualisht testohen per zhvleresim ne menyre individuale. Aktivitet e tjera financiare vleresohen ne menyre te grupuar, ne grupe qe kane karakteristika te ngjashme te rezikut.

Te gjitha humbjet nga zhvleresimi njihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve. Çdo shpenzim i akumuluar i lidhur me nje aktiv financiar i disponueshem per shitje i njohur me pare ne kapital, njihet ne shpenzime.

Nje humbje nga zhvleresimi rimerret nese rimarrja mund te lidhet objektivisht me nje ngjarje te ndodhur pas njohjes se humbjes nga zhvleresimi. Per aktivitet financiare te matura me kosto te amortizuar, rimarrja njihet ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve.

(ii) Aktivet jofinanciare

Vlera e mbetur e aktiveve jofinanciare te Shoqerise, rishikohet ne çdo date raportimi per te percaktuar nese ka te dhena per zhvleresim. Nese ka te dhena te tilla atehere vleresohet vlera e rikuperueshme e aktivitet.

Nje humbje nga zhvleresimi njihet nese vlera e mbetur e nje aktivi tejkalon vleren e tij te rikuperueshme. Humbjet nga zhvleresimi njihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve.

3.6 Perfitimet e punonjesve



Agrotal 2 sh.p.k.

Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2016

(shumat ne Lek)

Fondet e sigurimeve shoqerore, shendetesore dhe pensioneve

Bazuar ne legjislacionin shqiptar, Shoqeria eshte e detyruar te paguaje ne emer te punonjesve te saj kontribute te detyrueshme ne nje fond social te menaxhuar nga shteti. Pagesat dhe detyrimet e mbuluara nga Shoqeria njihen si shpenzime ne perudhen te ciles ato i perkasin.

3.7 Provigjonet

Nje provigjon njihet nese, si rezultat i nje ngjarjeje te shkuar, Shoqeria ka nje detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund te vleresohet ne menyre te besueshme dhe do te kerkoje flukse dalese parash per shlyerjen e tij. Provigjonet percaktohen duke skontuar flukset e pritshme te ardhshme te parase me nje norme skontimi para tatimit qe pasqyron vleresimet aktuale te tregut per vleren ne kohe te parase dhe per risqet qe lidhen me detyrimin ne fjale.

3.8 Njohja e te ardhurave

Shitja e mallrave

Te ardhurat nga shitja e mallrave gjate rrjedhes normale te biznesit maten me vleren e drejte, duke zbritur kthimet e mundshme te mallrave, zbritjet tregtare dhe rabatat. Te ardhurat njihen ateher kur rreziket dhe perfitimet e rendesishme jane transferuar tek bleresi, marrja e sherbimit eshte e sigurt, kostot perkatese si dhe kthimet e mundshme te mallrave mund te vleresohen ne menyre te besueshme, nuk ka perfshirje te shitesit ne menaxhimin e mallrave, si dhe shuma e te ardhurave mund te matet me besueshmeri.

Shitja e sherbimeve

Te ardhurat nga sherbimet e ofruara njihen ne pasqyren e te ardhurave ne varesi te fazes se perfundimit te transakcionit ne daten e bilancit. Asnje e ardhur nuk njihet nese ka pasiguri te larte lidhur me kryerjen e pageses dhe kostove perkatese.

3.9 Te ardhura dhe shpenzime financiare

Te ardhurat financiare perfshijne te ardhura interesi nga llogarite bankare dhe fitime nga kursi i kembimit qe njihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve. Te ardhurat nga interesi njihen mbi bazen e te drejtave dhe detyrimeve te konstatuara duke perdorur metoden e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare perfshijne shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i kembimit, ndryshimet ne vleren e drejte te aktiveve financiare te mbajtura me vlere te drejte nepermjet fitim/humbje, dhe humbjet nga zhvleresimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve me metoden e interesit efektiv.

3.10 Tatimi mbi fitimin

Tatimi mbi fitimin perfshin tatimin aktual dhe tatimin e shtyre. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin njihet si fitim ose humbje pervec nese lidhet me zera te njohur direkt ne kapital, rast ne te cilin njihet ne kapital.

Tatimi aktual eshte tatimi qe pritet te paguhet mbi fitimin e tatueshem te vitit, duke perdorur normen tatimore ne fuqi ose qe konsiderohet ne fuqi ne daten e raportimit, dhe çdo sistemim te tatimit te pagueshem per vitet e meparshme.

Tatimi i shtyre lind nga ndryshimet mes vlerave te njohura per aktivet dhe detyrimet e shoqerise te paraqitura ne pasqyren e pozicionit financiar ne perputhje me kerkesat e SKK dhe vlerave te njohura te ketyre aktiveve dhe detyrimeve nga autoritetet tatimore.

Agrotal 2 sh.p.k.
Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare per vitin e mbyllur
me 31 dhjetor 2016

(shumat ne Lek)

4. Mjete monetare

Mjetet monetare me 31 dhjetor 2016 dhe 2015 perbehen si me poshte:

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Llogari rjedhese:		
Lek	5,890	53,072
Euro	2,322	-
	8,212	53,072
Arka:		
Lek	-	-
Euro	-	-
	-	-
TOTALI	8,212	53,072

5. Aktive financiare afatshkurtra

Aktivitet financiare afatshkurtra me 31 dhjetor 2016 dhe 2015 perbehen si me poshte:

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
TVSH e kreditueshme	1,134,473	1,049,984
TVSH e rimbursueshme	93,256	93,256
TOTALI	1,227,729	1,143,239

6. Inventari

Inventari i Shoqerise me 31 dhjetor 2016 eshte 0 (zero) (2015: 0).

7. Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra

Shoqeria nuk ka parapagime dhe shpenzime te shtyra per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2016 (2015: 0).

8. Aktive afatgjata materiale

Aktivitet afatgjata materiale me 31 dhjetor 2016 dhe 2015 perbehen si me poshte:

Agrotal 2 sh.p.k.
Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare per vitin e mbyllur
me 31 dhjetor 2016

(shumat ne Lek)

	Mobilje dhe orendi	Pajisje zyre dhe informatike	Totali
Kosto			
Me 31 dhjetor 2015	82,667	320,667	403,334
Shtesa	-	-	-
Pakesime	-	-	-
Me 31 dhjetor 2016	82,667	320,667	403,334
Amortizimi i akumuluar			
Me 31 dhjetor 2015	(40,341)	(185,385)	(225,727)
Shtesa	(8,465)	(33,820)	(42,285)
Pakesime	-	-	-
Me 31 dhjetor 2016	(48,806)	(219,206)	(268,012)
Vlera e mbetur			
Me 31 dhjetor 2015	42,325	135,281	177,607
Me 31 dhjetor 2016	33,860	101,461	135,322

9. Aktive biologjike

Aktivitet biologjike me 31 dhjetor 2016 jane 9,810,000 Leke (2015:0)

10. Shpenzimet e zhvillimit

Shpenzimet e zhvillimit perfaqesojne shpenzime te kryera nga Shoqeria ne lidhje me masivin e ullirit, te cilat per shkak se Shoqeria nuk ka filluar aktivitetin e saj tregtar, jane kapitalizuar. Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2016 shpenzimet e zhvillimit jane ne vleren 26,847,665 Lek (2015: 22,509,257 Lek).

11. Detyrimet per t'u paguar dhe parapagime

Detyrimet per t'u paguar dhe parapagimet me 31 dhjetor 2016 dhe 2015 perbehen si me poshte:

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Furnitore	16,947,876	16,581,666
Detyrime ndaj personelit	1,204,618	1,427,246
Tatime dhe taksa:		
Sigurime shoqerore dhe shendetesore	100,236	86,500
Tatim mbi te ardhurat personale	4,750	4,750
Detyrime ndaj ortakut	10,051,091	5,863,005
TOTALI	28,308,571	23,963,166

12. Te ardhura nga aktiviteti

Shoqeria nuk ka realizuar te ardhura nga aktiviteti per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2016 (2015: 0).



Agrotal 2 sh.p.k.
Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2016

(shumat ne Lek)

13. Shpenzime administrative

Shpenzimet administrative per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2016 jane 9,653 Lek (2015: 0 Leke).

14. Kosto e punes

Kosto e punes me 31 dhjetor 2016 eshte 0 (zero) (2015: 0).

15. Te ardhura (shpenzime) nga kurset e kembimit, neto

Shoqeria nuk ka realizuar te ardhura (shpenzime) nga kurset e kembimit per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2016 (2015: 0).

16. Te ardhura (shpenzime) te tjera financiare, neto

Shoqeria nuk ka realizuar te ardhura (shpenzime) te tjera financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2016 (2015: 0).

17. Tatim-fitimi

Bazuar ne legjislacionin shqiptar, norma e tatimit mbi fitimin eshte 15% (2015: 15%).

Deklaratat tatimore dorezohen çdo vit por te ardhurat dhe shpenzimet e deklaruara per qellime tatimi konsiderohen vetedeklarime deri ne momentin qe autoritetet tatimore shqyrtojne deklaratat dhe regjistrimet e tatimpaguesit dhe leshojne vleresimin final. Ligjet dhe rregullat tatimore shqiptare jane objekt interpretimi nga autoritetet tatimore.

Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2016 Shoqeria rezulton me humbje kontabel ne vleren 9,653 Lek dhe me humbje fiskale 0 (zero) (2015: 0 Leke).

Me 31 dhjetor 2016, Shoqeria nuk ka detyrime apo aktive tatimore te shtyra.

18. Angazhime dhe pasiguri

Gjate aktivitetit te saj te zakonshem, Shoqeria mund te perfshihet ne pretendime apo veprime te ndryshme ligjore nga pale te treta. Me 31 dhjetor 2016 Shoqeria nuk ka çeshtje apo pretendime qe do te kene efekt negativ ne pozicionin financiar te Shoqerise ose ndryshime ne aktivet neto te saj. Gjithashtu, me 31 dhjetor 2016, Shoqeria nuk ka angazhuar kapitale te kontraktuara por ende te papaguara.

19. Ngjarje te mepasshme

Nuk ka asnje ngjarje te mepasshme pas dates se raportimit e cila kerkon rregullime apo shpjegime ne keto pasqyra financiare.